



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SANJA A. TELHALLARI
ADRESA Njesia Administrative Kashar,
Yzberish, Bulevardi "Migjeni"
TEL: +355672022444

PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K-VE (AKT THEMELIMI DHE STATUT)

Nr. repertori: 14171

Nr. koleksioni: 8875

Tirane më 17/07/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 12 fletë



A2024052120960817051



**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PERGJITHESI TE KUFIZUARA
"CUBI" SH.P.K**

Sot, më datë 17.07.2024 (dymije e njetete e kater), para meje Notere **SANJA A. TELHALLARI**, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Njesia Administrative Kashar, Unaza e Re, Rr. "Teodor Keko", u paraqit personalisht:

THEMELUES/IT:

Cubi Raman, atësia Rexhep, amësia Lumnije, shtetas Belg, lindur në Meru, France dhe banues në Belgjike, me adresë Rue de la Tombale n. 1A, 1350 Jauche, Belgjike, lindur më 18/10/1981, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID Belg, nr. 592-3017810-27 dhe nr. personal 81.10.18-249.12.

THEMELUES/IT:

Vatansever Azur, atësia Faruk, amësia Pervin, shtetase Belge, lindur në Belgjike, Bruksel, dhe banues në Belgjike, me adresë Rue de la Tombale n. 1A, 1350 Jauche, Belgjike, lindur më 19/06/1983, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID Belg, nr. 595-1956670-04 dhe nr. personal 83.06.19-246.96.

Baza Ligjore:

- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar
- Neni 62, pika 1, gërma "1" të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"

Rrethanat për hartimin e aktit noterial:

Personat me identitetin e mësipërm shprehën vullnetin e tyre të lirë e të plotë, për të krijuar një shoqëri tregtare, të formës shoqërise me pergjegjesi te kufizuar e cila do të krijohet dhe veprojë sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare, si dhe do të referohet për mbarëvajtjen e saj në Aktin e Themelimit dhe Statutit të krijuar nëpërmjet këtij akti.

Në zbatim të gërmës "1" të pikës 1 të nenit 62 të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", ku parashikohet: Kompetencat e noterit/es: l) përpilon dhe merr pjesë aktive në hartimin e akteve të shoqërive tregtare, unë noterja marr pjesë gjatë hartimit të Aktit të Themelimit dhe të Statutit të shoqërisë.

**NENI 1
ORTAKET THEMELUES**

Shoqëria me pergjegjesi te kufizuar "CUBI" Sh.p.k, themelohet nga ortakët;

1) **Cubi Raman**, atësia Rexhep, amësia Lumnije, shtetas Belg, lindur në Meru, France dhe banues në Belgjike, me adresë Rue de la Tombale n. 1A, 1350 Jauche, Belgjike, lindur më 18/10/1981, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID Belg, nr. 592-3017810-27 dhe nr. personal 81.10.18-249.12.

dhe


2) **Vatansever Azur**, atësia Faruk, amësia Perin, shtetase Belge, lindur në Belgjike, Bruksel, dhe banues në Belgjike, me adresë Rue de la Tombale n. 1A, 1350 Jauche, Belgjike, lindur më 19/06/1983, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID Belg, nr. 595-1956670-04 dhe nr. personal 83.06.19-246.96.

**NENI 2
PERSONALITETI JURIDIK**

Shoqëria "CUBI" Shpk do të jete person juridik shqiptar. Kjo do ta fitoje personalitetin juridik kur të regjistrohet pranë Qendres Kombetare te Biznesit te Shoqerive Tregtare, ndersa veprimtarine ekonomike do ta filloje pasi te pajiset me lejen perkatese nga organet kompetente. Veprimtaria e Shoqerise do te rregullohet sipas dispozitave te ketij akti themelimi, Statutit bashkalidhur



dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.



**NENI 3
SELIA**

Shoqeria "CUBI" sh.p.k do ta kete seline ne Republiken e Shqiperise, konkretisht Tirane, Njesia Bashkiake nr. 7, Rruga e Kavajes, Ish-Parku, Zona Kadastrale nr. 8220, Numer i Pasurise 6/284.

**NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarise te Shoqerise " CUBI" Sh.p.k do te jete: **"Import/Eksport, Tregti me Shumice dhe Pakice te Produkteve te Duhanit dhe te tjera te ngjashme, Produkte Ushqimore, Pije Freskuese dhe Pije Alkoolike, Take and Go, Sherbim Delivery 24h, Sherbim Bar-Restorant, Ushtrim i Cdo Veprimtarie te Ligjshme te Lejueshme per Formen e Shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj, sipas Nenit 7, te ligjit tregtar nr. 9901, date 14.04.2008 "**.

Veprimtaria e shoqerise do te jete per nje afat te pacaktuar.

**NENI 5
KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali i shoqerise perbehet vetem nga kontributi ne para, i perbere nga 2(dy) kuota me vlere nominale **100.000 ALL (Njeqind mije leke).**

Ky kapital do jete si me poshte vijon:

Ortaku Cubi Raman do te jete zoterues i 1(nje) kuote me vlere 50% te kapitalit, me vlere nominale 50,000 ALL (pesedhjete mije leke).

dhe

Ortakja Vatansever Azur do te jete zoteruese i 1(nje) kuote me vlere 50% te kapitalit, me vlere nominale 50,000 ALL (pesedhjete mije leke).

**NENI 6
FONDET E SHOQERISE**

Shoqeria do te krijoje fondet perkatese, te cilat do te specifikohen ne Statutin e Shoqerise, dhe do te mbahen ne Librin e caktuar per kete qellim.

**NENI 7
NDARJA E FITIMIT TE SHOQERISE**

Fitimi neto qe do te realizohet nga shoqeria, d.m.th. qe do te mbetet pas shlyerjes te te gjitha detyrimeve dhe pas vecimit te fondeve te detyruara, do t'i kaloje ortakeve.

**NENI 8
PERGJEGJESITE E ORTAKEVE**

Ortaket jane pergjegjes kundrejt te treteve per pasojat dhe demet qe rrjedhin nga anullimi ose deklarimi i pavlefshem i aktit te themelimit te shoqerise.

Po ashtu, ortaket jane pergjegjes ne masen 100 % edhe per te gjitha humbjet qe mund te rezultojne gjate aktivitetit ekonomik te shoqerise.

**NENI 9
DISPOZITE E PERGJITHESHME**

Problemet e kapitalit themeltar dhe te pjeseve nominative, transferimi i kapitalit, zmadhimi dhe zvoglimi i kapitalit, menyra e administrimit te shoqerise, emerimi i administratoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar, kompetencat dhe pergjegjesite e tyre, menyra e mbajtjes se llogarive, falimentimi dhe humbja e kapitalit themeltar, shnderrimi i shoqerise, zgjidhja e mosmarrveshjeve dhe problemet e tjera qe lidhen me veprimtarine e shoqerise do te zgjidhen sipas dispozitave te Statutit te Shoqerise dhe, ne mungese te tyre, nga legjislacioni ne fuqi.



A2024052120960817051

STATUTI

I

Shoqërise me përgjegjësi të kufizuar "CUBI" Sh.p.k.

Sot me datë 17/07/2024, themeluesit deklarojnë se Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin "CUBI" Sh.p.k, e themeluar prej ortakëve Cubi Raman dhe Vatansever Azur, do ta zhvillojë veprimtarinë e saj sipas dispozitave të poshtshënuara të këtij Statuti në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar me ligjin nr.129/20.

KREU I

DISPOZITA TË PËRGIITHESHME

NENI 1

FORMA JURIDIKE E SHOQËRISE

Shoqëria "CUBI" sh.p.k është themeluar nga;

1) **Cubi Raman**, atësia Rexhep, amësia Lumnije, shtetas Belg, lindur në Meru, France dhe banues në Belgjikë, me adresë Rue de la Tombale n. 1A, 1350 Jauche, Belgjikë, lindur më 18/10/1981, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID Belg, nr. 592-3017810-27 dhe nr. personal 81.10.18-249.12.

dhe
2) **Vatansever Azur**, atësia Faruk, amësia Perin, shtetase Belge, lindur në Belgjikë, Bruksel, dhe banues në Belgjikë, me adresë Rue de la Tombale n. 1A, 1350 Jauche, Belgjikë, lindur më 19/06/1983, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID Belg, nr. 595-1956670-04 dhe nr. personal 83.06.19-246.96.

NENI 2

KOHEZGJATJA E SHOQËRISE

Kohezgjatja e Shoqërise është për afat kohor të pacaktuar.

NENI 3

PERSONALITETI JURIDIK

- Shoqëria "CUBI" sh.p.k. fiton personalitetin juridik ditën që regjistrohet në Qendren Kombëtare të Regjistrimit të Shoqërive Tregtare.
- Viti i parë financiar i Shoqërise fillon ditën do leshohet leja përkatëse nga organet tatimore dhe do të mbyllet me datën 31 Dhjetor të te njejtë vit, ndërsa vitet e tjera financiare do të fillojnë me datën 1 janar dhe do të përfundojnë me datën 31 Dhjetor të te njejtë vit.
- Rregullimi juridik i veprimtarisë së shoqërise do të bëhet sipas dispozitave të Aktit të Themelimit të Shoqërise, të këtij Statuti dhe legjislatcionit shqiptar në përgjithësi.

NENI 4

SELIA E SHOQËRISE

Shoqëria "CUBI" sh.p.k, do ta ketë selinë në Republikën e Shqipërisë, konkretisht Tirane, Njësia Bashkiake nr. 7, Rruga e Kavajës, Ish-Parku, Zona Kadastrale nr. 8220, Numer i Pasurisë 6/284.

Shoqëria mund të krijojë dege ,perfaqesi ose agjensi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 5

VULA E SHOQËRISE

Shoqëria ka vulën e saj në formë të rrumbullakët ose katrorë dhe me mbishkrimin "CUBI" shpk.



A2024052120960817051

NENI 6
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise te Shoqerise "CUBI" Sh.p.k do te jete **"Import/Eksport, Tregti me Shumice dhe Pakice te Produkteve te Duhanit dhe te tjera te ngjashme, Produkte Ushqimore, Pije Freskuese dhe Pije Alkoolike, Take and Go, Sherbim Delivery 24h, Sherbim Bar-Restorant, Ushtrim i Cdo Veprimtarie te Ligjshme te Lejueshme per Formen e Shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj, sipas Nenit 7, te ligjit tregtar nr. 9901, date 14.04.2008 "**.

KREU II
KAPITALI THEMELTAR

NENI 7
KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTA

Kapitali i shoqerise perbehet vetem nga kontributi ne para, i perbere nga 2(dy) kuota me vlere nominale **100.000 ALL (Njeqind mije leke).**

Ky kapital do jete si me poshte vijon:

- **Ortaku Cubi Raman** do te jete zoterues i 1(nje) kuote me vlere 50% te kapitalit, me vlere nominale 50,000 ALL (pesedhete mije leke). dhe
- **Ortakja Vatansever Azur** do te jete zoteruese i 1(nje) kuote me vlere 50% te kapitalit, me vlere nominale 50,000 ALL (pesedhete mije leke).

NENI 8
ZMADHIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Zmadhimi i kapitalit themeltar behet me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Zmadhimi i kapitalit themeltar nuk perfaqeson kontributet ne sherbime.

Ne cdo rast, zmadhimi i kapitalit themeltar shoqerohet edhe me ndryshimet perkatese ne QKB, ku percaktohet shprehimisht pjesmarrja e ortakeve ne kapitalin themeltar te zmadhuar si dhe kuota e re.

NENI 9
ZVOGLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Zvoglimi i kapitalit themeltar behet me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Zvoglimi i kapitalit themeltar e prek ortakun ne ate mase, sa jane pjeset e kapitalit qe ai perfaqson. Kur merret vendim per zvoglimin e kapitalit themeltar nen limitin e parashikuar ne Kodin Tregtar per Sh.p.k.- te, i cili motivohet nga humbjet e rezultuara, atehere ky vendim do te shoqerohet me keto veprime:

1. Ndryshimi i tipit te shoqerise;
2. Ndryshimi i Statutit;
3. Publikimi dhe njoftimi i te treteve me te cilet shoqeria ka mardhenie kontraktuale si dhe i kreditoreve.

Kur miratohet nje projekt vendim per zvoglimin e kapitalit themeltar, qe nuk motivohet nga humbjet, kredoret, kredia e te cileve eshte dhene para dates se publikimit te ndryshimeve perkatese ne Statut, mund ta kundershtojne zvoglimin e kapitalit brenda 1 (nje) muaji nga kjo date ne rruge gjyqësore.

NENI 10
TRANSFERIMI I PJESEVE NOMINATIVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Pjeset nominative te kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rast ndarjeje pasurore midis bashkeshorteve, ne rruge trashegimie tek paraardhesit dhe pasardhesit si dhe tek te tretet.

Transferimi i pjeseve nominative te kapitalit themeltar behet me miratimin e ortakeve te shoqerise.



A2024052120960817051

Ne te gjitha rastet e transferimit, cmimi i pjeseve nominative te kapitalit themeltar do te caktohet sipas vleres aktuale te bilancit te shoqerise ne momentin qe do te behet transferimi.

KREU III
ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 11
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per percaktimin e politikave tregetare te shoqerise, per ndryshimet e statutit, emerimin dhe shkarkimin e administratoreve, emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar, si dhe te gjithe te drejtat e detyrimit e tjera te parashikuara ne ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregaret dhe shoqerite tregetare". Te drejtat dhe detyrimet e Asemblese se Pergjithshme ushtrohen nga ortakeve.

Te gjitha vendimet e marra nga ortakeve, regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Duhet regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- 1) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- 2) Shpemdarrjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- 3) Investime;
- 4) Vendime per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;

Vendimet e paregjistruara ne regjistrine e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme.

NENI 12
ADMINISTRATORI DHE MENYRA E CAKTIMIT

Administratori i Shoqerise "CUBI" Sh.p.k. eshte **Cubi Raman**, lindur me 18/10/1981, per afatin kohor 5 vjet, me te drejte ripertesitje, i cili fillon me 17/07/2024.

Administratoret caktohen nga Asambleja e Pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme mund te caktojte nje ose me shume administratore, te cilet mund te jene persona vendas ose te huaj.

NENI 13
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori i Shoqerise "**CUBI**" **Sh.p.k.** ka te gjitha kompetencat qe ligji ka caktuar per administratoret, pa asnje kufizim.

Lejohet qe administratori te delegoje tek personat e trete nje apo disa nga kompetencat qe kane te bejne me ushtrimin e funksioneve te vecanta, si drejtimi teknik, drejtimi financiar, etj.

Administratori ka te drejte qe te dorehiqet ne menyre te njehshme me detyrimin e njoftimit te ortakeve ne nje nga format qe do ta konsideroj te arsyeshme nepermjet e-mail-it te deklaruar ne rubriken ortaket te ketij statuti ose nepermjet sherbimit postar ne adresen e deklaruar ne rubriken palet te ketij statuti dhe mbas permbushjes se detyrimit te njoftimit me nje nga menyrat e njoftimit dhe kalimin te afatit 30 ditor administratori nuk ka asnje kompetence ne Shoqeri dhe nuk ka asnje detyrim ligjor apo financiar ndaj Shoqerise dhe ndaj te treteve.

NENI 14
NDRYSHIMET E STATUTIT

Ndryshimet e Statutit behen me vendimin e Asemblese se Pergjithshme dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 15
EMERIMI DHE SHKARKIMI I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR

Ekspertet kontabel i autorizuar emerohet me vendim te Asemblese se Pergjithshme .Ne rast gabimi ose pengimi, eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet nga funksionet e tij me vendim te Asemblese se Pergjithshme.

Jane te pavlefshme: shqyrtimet e bera pa ekspert kontabel te autorizuar kur kjo eshte e detyrueshme nga ligji, si dhe raportet e eksperteve kontabel, qe jane emeruar ne kundersizim me rregullat e



A2024052120960817051

parashikuara nga Ligji nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 16
SHNDERRIMI I SHOQERISE

Shnderrimi i shoqerise "CUBI" Sh.p.k. ne nje shoqeri aksionare behet me vendim te Asamblese se Pergjithshme me nje shumice prej tre te katertave dhe sipas procedures percaktuar ne ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
Para marrjes se vendimit per shnderrimin ne shoqeri anonime ,njoftohet per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

KREUI V
FITIMI DHE DIVIDENTET

NENI 17
SHPERNDARJA E FITIMIT

Fitimi qe do te shpemdahet perbehet nga fitimi i vitit financiar, pasi zbriten ose shtohen respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mepareshme.
Asamblese se Pergjithshme mund te marre vendim qe te shpemdaje edhe shumat e lena menjane per rezerven qe ka ne dispozicion, por ne kete rast vendimi duhet te tregojte shprehimisht llojin e rezerves ku merren shumat.

NENI 18
PERCAKTIMI I DIVIDENTEVE

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te shumes qe do te shpemdahet, Asamblesja e Pergjithshme percakton pjesen qe i takon ortakut ne forme dividenti.. (Ndarja e fitimit ne raport me kuoten qe zoterojne ortakët).
Shoqeria ka te drejte te jape edhe paradhenie, vlera e te cilave ka rrjedhur nga vitet financiare te mbyllura ose ne vazhdim, vlera keto te derdhura para mbylljes se vitit financiar, me kusht qe te veprohët ne konformitet me Ligjin ne fuqi.

KREUI VI
PAVLEFSHMERITE, PRISHJET DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

NENI 19
RASTET E PAVLEFSHMERIVE

Pavlefshmeria e shoqerise "CUBI"Sh.p.k. dhe paviefshmeria e akteve perkatese te saj (Akt Thernelimi, Statut, Vendime Asambleje, Raporte te ekspertit kontabel te autorizuar, te veprimeve te administratoreve, etj.) mund te rezultojne vetem nga shkeljet e dispozitave urdheruese apo ndaluese te Ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " ose te legjisiacionit ne fuqi per kontratat dhe veprimet juridike, te parashikuara ne Kodin Civil.

NENI 20
PRISHJA E SHOQERISE

Prishja e shoqerise "CUBI "Sh.p.k. hpallet nga Asambleja e Pergjithshme ne rast;

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b. Me vendimet e asamblese se Ortakeve
- c. Me hapjen e procedurave te falimentit
- d. Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit,
- e. Me vendim gjykate

NENI 21
LIKUIDIMI



A2024052120960817051

Ne te gjitha rastet, kur me vendim te QKB shpallet pavlefshmeria absolute apo relative e shoqerise, si dhe ne rastet kur asambleja merr vendim per prishjen e saj (raste te parashikuara ne Statut), fillon procesi i likuidimit te shoqerise, proces i cili do te kryhet sipas kerkesave te parashikuara ne Kodin Tregtar Shqiptar.

Për sa më sipër, u hartua Statuti i shoqërisë me pergjegjesi te kufizuar "CUBI" shpk, nga unë noterja, në prezencë të ortakëve të shoqërisë, bazuar në vullnetin e lirë e të plotë të tyre, si dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare. Pasi u lexua qartazi dhe u kuptua rëndësia dhe efektet ligjore, nënshkruhet Statuti i shoqërisë me pergjegjesi te kufizuar "CUBI" shpk.

Unë Noterja, verifikova identitetin e tij/saj nëpërmjet dokumenteve të identitetit cituar më sipër dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin nenit 62, pika 1, germa "II", të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoi nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti noterial, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

THEMELUES/IT
Cubi Raman

Raman CUBI

THEMELUES/IT
Vatansever Azur

Azur VATANSEVER



NOTERE
SANJA A. TELHALLARI